



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 20

DATË

29.03.2024

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 113, DATË 14.12.2023 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024” NGA SHPËRNDARJA E TË TRASHËGUARËS NGA VITI 2023”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 29.03.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një shtesë në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” nga shpërndarja e të trashëguarës nga viti 2023”. Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimin nr 09. datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB nr 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023”, VKB nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”.

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” nga shpërndarja e të trashëguarës 2023 sipas aneksit nr 1 dhe nr 2, bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

